



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**V E N D I M**

**Nr.2493, datë 10.07. 2014**

**Për**

**“Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik, të realizuar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.07.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP”**

**B A Z A L I G J O R E:**

1. Neni 78, 86, 110 si dhe shkronja c) dhe ç) të pikës 1 si dhe pika 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
2. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP;

## **K Ë SH I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Informacioni mbi zhvillimin e Këshillimit Publik;
- Raporti i AKEP mbi Këshillimin Publik të realizuar;
- Projekt Vendimi i Këshillit Drejtues mbi “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP”;
- Projekt Vendimit për Këshill të Ministrave ” Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike” dhe Relacionin shoqërues;
- si dhe, duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

## **V Ë R E N:**

1. Materiali i përgatitur për publikimin e raportit të AKEP mbi këshillimin publik të realizuar për dokumentin “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” me qëllim që palët me interes të njihen me opinionet, përgjigjes së AKEP-it si dhe vendimit të tij lidhur me çështjen e nxjerrë për këshillim;
2. Propozimet e paraqitura nga Grupi i punës, lidhur me kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP, nëpërmjet projekt aktit për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”, së bashku me pagesat që kryhen në AKEP për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike në zbatim të Rregullores nr. 20, “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”, përbëjnë paketën e akteve nënligjore mbi pagesat që kryhen në AKEP, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së AKEP, si organ rregullator në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008;

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, në zbatim të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 si dhe pikave 12 dhe 17 të Rregullores,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë publikimin e raportit të AKEP, mbi procesin e Këshillimit Publik me palët e interesit për dokumentin: “Mbi kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP”
2. Të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin dhe

relacionin përkatës “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP”.

3. Ngarkohet Kryetari për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij;

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	1
2. PAGESAT AKTUALE PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE .....	3
3. PROPOZIMET E PAGESAVE PËR SPEKTRIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMET RADIO .....	3
4. PROPOZIM PËR TEPRICËN E TË ARDHURAVE TË FUND VITIT.....	5
5. PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM.....	7

## 1. HYRJE

AKEP, në bazë të gërmës a) pika 3 e nenit 62 të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është autoriteti rregullator kombëtar, përgjegjës për të administruar spektrin e frekuencave të caktuar për qëllime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizione.

Sipas Ligjit nr. 9918 dhe legjislacionit të BE, AKEP duhet të caktojë pagesa, për mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe përdorimin optimal të spektrit të frekuencave të radios. Këto pagesa duhet të jenë objektivist të justifikuara, jo-diskriminuese, proporcionale, të nxisin konkurrencën, përdorimin efikas, sigurimin e menaxhimit efektiv të përdorimit të frekuencave dhe të numrave dhe duhet të përputhen me koston administrative vjetore të AKEP-it për administrimin e radiofrekuencave dhe numrave.

Në lidhje me pagesat që kryhen në AKEP gërmat a), c) dhe ç) të nenit 119 të ligjit nr. 9918 përcaktojnë se sipërmarrësit, duhet të kryejnë pagesat në AKEP për:

a) mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 24 të këtij ligji;

c) Caktimin dhe përdorimin e frekuencave, dhe

ç) Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike.

Pagesat për mbikqyerjen e tregut të Komunikimeve Elektronike, janë aplikuar për operatorët e komunikimeve elektronike (rrjeti dhe/ose shërbime publike) në vitet 2013 dhe 2014, i cili është rreth

0.1% e të ardhurave vjetore të operatorëve të komunikimeve elektronike deri në 0.5 % e përcaktuar në nenin 24 të Ligjit sepse të ardhurat e buxhetit janë plotësuar kryesisht nga pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike dhe pagesa të tjera.

Pagesat për mbikqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike për vitet në vazhdim i propozojmë të rriten nga 0.1% në 0.32%.

Pagesat që kryen në AKEP për caktimin dhe përdorim e frekuencave, për shërbimet e ndryshme radio, janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar (VKM Nr.911,datë 19.12.2012) *“Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”*.

Duke u nisur nga eksperiencia e dy viteve të fundit mbi të ardhurat vjetore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, mbi menaxhimin e spektrit të frekuencave, të cilën e karakterizon dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike, vlerësojmë se pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike duhet rritur dhe pagesat për përdorim frekuencash si pas përcaktimeve në VKM nr. 599 i ndryshuar, duhen ndryshuar me qëllim që të nxisin një mjedis më të favorshëm, jo diskriminues me synimin e përafrimit të pagesave me koston administrative për administrimin e radiofrekuencave.

Për të krijuar një raport sa më të drejtë për pagesat që bëjnë sipërmarrësit janë hartuar tregusit finaciare të AKEP, për vitet 2014-2015 e në vazhdim.

Për këto arsye, AKEP ka menduar rishikimin e pagesave për mbikqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike dhe për përdorimin e frekuencave radio për:

- Shërbimin telefonik publik i lëvizshëm tokësor;
- Lidhje fiks radio;
- Frekuencave GSM/ UMTS.

AKEP në zbatim të Lligjit Nr. 9918 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1183, datë 10.03.2010, në kuadër të transparencës dhe paanësisë nxjerr për Këshillim Publik “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” me propozim për disa ndryshime në VKM nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar.

Qëllimi i këtij dokumenti është të rishikojë pagesat e tanishme, të aplikuara për shërbime të caktuara radio dhe të kërkojë mendime dhe komente mbi ndryshimet e propozuara, të cilat ndikojnë në

përdorimit dhe menaxhim efektiv të spektrit të frekuencave radio, inkurajojnë shfrytëzimin e mëtejshëm të spektrit radio nga sipërmarrësit ose operatorë të rrjetit të komunikimeve elektronike publike e private dhe përdoruesit e tjerë të pajisjeve-radio dhe duke përputhur koston administrative të AKEP për administrimin e radiofrekuencave.

### **Dërgimi i Komenteve**

Të gjitha komentet janë të mirëpritura, do të vlerësonim që çdo koment/përgjigje t'i referohet pyetjes me numrin përkatës që ka ky dokument konsultimi.

Periudha e konsultimit do të zhvillohet nga data **24.07.2014** deri më date **25.08.2014**.

Gjatë kësaj periudhe AKEP mirëpret komentet me shkrim për çdo çështje të ngritur në këtë dokument.

AKEP, gjatë periudhës së Këshillimit Publik do të zbatojë procedurat dhe kërkesat përkatëse në përputhje me Udhëzuesin e Procedurave për Këshillimin me Publikun miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe do të zbatojë kërkesat për ruajtjen e kofidencialitetit të të dhënave që do të paraqesin palët e interesuara.

## **2. PAGESAT AKTUALE PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE.**

Pagesat aktuale, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike bëhen sipas VKM Nr.599, i ndryshuar, datë 23.07.2010. Këto pagesa janë bazuar përgjithësisht në veçoritë e brezave të frekuencave dhe të shërbimeve përkatëse radio si dhe në raste të veçanta për paisjet radio për disa kategori shërbimi siç janë :

Përmbajtja e plotë VKM Nr.599, datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM 911, dt 19.12.2012 mund të gjendet në faqen elektronike të AKEP në linkun <http://akep.al/images/stories/AKEP/legjislacioni/dokumentet-pagesave/vkm-nr-599-dat-23-7-2010.pdf>.

AKEP në vijim ju paraqet propozimet për ndryshimet në pagesat për përdorimin e frekuencave duke i krahasuar me ato që janë në përdorim deri tani.

## **3. PROPOZIMET E PAGESAVE PËR SPEKTRIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMET RADIO**

### **3/1. Lidhjet fikse radio.**

Në këto shërbime propozohet zvogëlimi i pagesave i përcaktuar sipas VKM. Nr.599 datë 23.07.2010, i

ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012, për përdorimin e frekuencave radio, për lidhjet fikse, duke zvogëluar koeficientët përkatës apo vlerën në lekë të njësisë së tij.

Propozimi për zvogëlimin e nivelit të pagesës për çdo lidhje radio është në tabelën e mëposhtme:

Sipas VKM 911, date 19.12.2012					PROPOZIMI					Ndryshimi ne % ( zbritje)			
Pagesat ne 000/leke					Pagesat ne 000/leke								
Brezi	Gjeresi kanalit radio MHz				Brezi	Gjeresi kanalit radio MHz				Gjeresi kanalit radio MHz			
GHz	≤ 3.5	÷20	÷ 40	> 40	GHz	≤ 3.5	÷20	÷ 40	> 40	≤ 3.5	÷20	÷ 40	> 40
1÷ 14	40	50	55	75	1÷ 14	24	30	33	45	40.0	40.0	40.0	40.0
14÷ 20	35	45	50	65	14÷ 20	21	27	30	39	40.0	40.0	40.0	40.0
20÷ 37	28	35	45	50	20÷ 37	16.8	21	27	30	40.0	40.0	40.0	40.0
37÷ 39.5	20	30	35	45	37÷ 39.5	12	18	21	27	40.0	40.0	40.0	40.0
> 39.5	8	10	12	15	> 39.5	4.8	6	7.2	9	40.0	40.0	40.0	40.0

Propozimet sipas tabelës së mësipërme për lidhje radio ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave financiare në lidhjet fikse për operatorët e komunikimeve elektronike në nivelin 35 - 40 %.

Ndikimi në pagesat e operatorëve të komunikimeve elektronike nga propozimi për zvogëlim të koeficientëve të pagesave lidhjet fikse radio paraqitet në tabelën e mëposhtme.

SUBJEKTI	Nr.Link	VKM 599, i ndryshuar	PROPOZIMI	Ndryshimi në %
ALBTELECOM SHA	508	23,270,000	15,912,000	31.7
AMC	882	38,880,000	26,709,000	31.3
PLUS COMMUNICATION	371	17,235,000	11,394,000	33.9
VODAFONE ALBANIA	846	36,998,000	25,876,800	30.1
OPERATOR Alternativë		4,700,000	2,810,000	40.2
<b>NE TOTAL</b>		<b>121,083,000</b>	<b>82,701,800</b>	<b>31.7</b>

Nga zvogëlimi i koeficientëve të pagesave për lidhje radio fikse që propozohet, ndikon në zvogëlimin e pagesave në shumën rreth 38,381,200 lekë ose 31.7%.

### 3/2. Brezi i Frekuencave GSM/ UMTS.

Në këto shërbime propozohet zvogëlimi i pagesave i përcaktuar sipas VKM. Nr.599 datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012, për përdorimin e frekuencave GSM/UMTS, duke zvogëluar pagesën në lekë për kanal.

Për përdorimin e frekuencave GSM / UMTS propozohet zvogëlimi i pagesës për kanal rreth 40%.

Propozimi për zvogëlimin e nivelit të pagesës për kanal është në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Kanali	VKM 599,i ndryshuar	Propozimi	
			Propozimi	Ndryshimi %
Brezat e frekuencave		Vlera		
(450-470)	(2*5) MHz	2,500,000	1,500,000	40
(790-880)	(2*5) MHz	2,300,000	1,400,000	39.1
(880-915) / (925-960)	(2*200) kHz	70,000	42,000	40
(1710-1785) / (1805-1880)	(2*200) kHz	70,000	42,000	40
(1920-1980) / (2110-2170)	(2*5) MHz	1,400,000	840,000	40
(1900-1920) / (2010-2025)	(1*5) MHz	700,000	420,000	40
(2500-2570 ) / (2620-2690)	(2*5) MHz	1,200,000	720,000	40
(2570-2620)	(1*5) MHz	600,000	360,000	40
(3400-3600) / (3600-3800)	(2*5) MHz	1,000,000	600,000	40

Ndikimi në pagesat nga propozimi për zvogëlimin e pagesave për brezin e frekuencave GSM/ UMTS , paraqitet në tabelën e mëposhtme:

VKM 599,i ndryshuar					Propozimi		Ndryshimi
Brezat e frekuencave	Kanali	Sasia	Vlera	Shuma	Vlera	Shuma	%
450-470 MHz	(2*5)MHz		2,500,000		1,500,000		
790-880 MHz	(2*5)MHz		2,300,000		1,400,000		



GSM/UMTS 900 (880-915)/(925-960)MHz	(2*200) kHz	160	70,000	11,200,000	42,000	6,720,000	40
GSM/UMTS 1800 (1710-1785)/(1805-1880) MHz	(2*200) kHz	180	70,000	12,600,000	42,000	7,560,000	40
UMTS (1920-1980)/(2110-2170)	(2*5)MHz	3	1,400,000	8,400,000	840,000	5,040,000	40
UMTS (1900-1920); (2010-2025)	(1*5) MHz	3	700,000	2,100,000	420,000	1,260,000	40
(2500-2690) [(2500-	(2*5)MHz		1,200,000		720,000		
2570)/(2620-2690)							
2570-2620	(1*5) MHz		600,000		360,000		
(3400-3600)/(3600-3800MHz	(2*5)MHz		1,000,000		600,000		
<b>SHUMA</b>			<b>0</b>	<b>34,300,000</b>	<b>0</b>	<b>20,580,000</b>	<b>40</b>

Zvogëlimi i pagesës për kanal të brezit të frekuencave të GSM / UMTS ndikon në zvogëlimin e pagesave në shumën 13,720,000 lekë ose 40%.

#### 4. PROPOZIM PËR TEPRICË E TË ARDHURAVE TË FUND VITIT TË MBAHET NË LLOGARI TË AKEP-it.

Teprica e të ardhurave që mbeten nga shpenzimet në fund të vitit financiar i propozojmë të mbahen në llogari të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të përfshihen në programin e financimit të shpenzimeve të vitit pasardhës dhe të mbahen parasysh duke i zbritur në llogaritjet dhe faturimet e pagesave që u bëhet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike në vitin pasardhës.

## 4 PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM:

### 1. Rritja e nivelit të pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike.

**2. Propozimet e pagesave për spektrin e frekuencave për shërbim radio.**

- Lidhje fiks radio;
- Brezi i frekuencave GSM/ UMTS.

**3. Teprica e të ardhurave të fund vitit të mbahet në llogarit të AKEP.**

- Pyetje Nr.1** *A jeni dakort të rritet pagesa për mbikqyerjen e tregut dhe të ulen pagesat për caktim dhe përdorim të radiofrekuencave?*
- Pyetje Nr. 2** *A jeni dakort të ruhet e njëjta strukturë e tabelës së mësipërme lidhur me ndarjen e brezave te frekuencave radio për llogaritjet e pagesave ?*
- Pyetje Nr. 3** *Cili është mendimi Juaj për vlerat e pagesave të propozuara?*
- Pyetje Nr. 4** *Cili është mendimi Juaj për tepricën e të ardhurave të AKEP në fund të vitit?*
- Pyetje Nr. 5** *A jeni dakord që teprica e të ardhurave të AKEP në fund vitit të zbriten nga pagesat e sipërmarrësve në vitin pasardhës?*